



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:912825

Datë: 25.02.2021

Numri i dokumentit: 01543185

Ac.nr.4864/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim L.S, kundër të paditurës D.G nga Skenderaj, me vendbanim të panjohur, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm M.T, avokat nga Skenderaj, për rimbursimin e dëmit, vlera e kontestit 1,884.50€, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, C.nr.10/2016 i datës 13.05.2019, në seancën e kolegjit e mbajtur më dt.04.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës D.G nga Skenderaj, me vendbanim të panjohur, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, C.nr.10/2016 i datës 13.05.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS) me seli në Prishtinë. Me të njëjtin aktgjykim në pikën II të dispozitivit, detyrohet e paditura D.D.G nga Skenderaj Rr.”...” pn, që paditëses në emër të rimbursimit (regresit) të dëmit të cilin e ka shkaktuar e paditura me dt.23.12.2012 rreth orës 16:30 në Skenderaj, në rrugën “...” t’i paguaj shumën prej 1,884.50 euro për automjetin e dëmtuar të tipit Mercedes Benz, me tagra regjistrimit ..., pronar NPT”A...” në Skenderaj, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë për taksë për padi 20 euro dhe për aktgjykim shumën prej 20 euro, të gjitha këto shuma në afatin prej 15 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurës, brenda afatit ligjor ka paraqitë ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të

vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i atakuar, ashtu që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses dhe të detyrohet paditësja, që të paguaj shpenzimet e procedurës në lidhje me ankesën dhe taksën gjyqësore për ankesë në shumë prej 238 euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësja me dt.06.01.2016, ka ushtruar padi në gjykatë kundër të paditurës, me pretendimin që e paditura nga pakujdesia ka shkaktuar aksident trafiku në Skenderaj, duke e goditur automjetin e tipit “Mercedes Benz”, me tagra regjistrimit ..., pronë e NPT ”A...” në Skenderaj. Automjetin të cilin e drejtonte e paditura, ishte i pasiguruar, përkatësisht, i kishte skaduar periudha e sigurimit në momentin e aksidentit. I dëmtuari NPT “A...” ka ushtruar kërkesë për kompensimin e dëmit dhe paditësja në përputhje me detyrimet që dalin nga Ligji nr. 04/L-018, për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, sipas nenit 18, e ka bërë rimbursimin e dëmit sipas vlerësimit të Komisionit, me vendimin nr.A...dhe ka paguar shumën prej 1,884.50€, sipas Ujdisë jashtë gjyqësore nr.A...dt.19.04.2013, si dhe është bërë urdhër transferi i këtyre mjeteve.

Paditësja gjatë shqyrtimeve kryesore dhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë padisë me propozim që të aprovohet padia e paditëses, si dhe meqë të paditurës, nuk i dihet vendbanimi, ka propozuar që ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka vërtetuar gjendjen faktike se, në mes palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti që me dt.23.12.2012, kishte ndodhur aksident trafiku dhe që e paditura ishte shkaktare e vetme e këtij aksidenti. Pastaj, pas lidhjes së Ujdisë jashtë gjyqësore, në mes të dëmtuarit në këtë aksident dhe paditëses, paditësja ka bërë pagesën për dëmin e shkaktuar në shumë prej 1,884.50€, shumë e bazuar në emër të servisit të autorizuar që e ka bërë rregullimin e automjetit të të dëmtuarit dhe me dt.19.04.2013 ka bërë urdhrin për transfer, ndërkaq me dt.30.04.2013, është bërë transferi i mjeteve në shumën e lartcekur. Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes ka marrë parasysh dhe vlerësuar edhe kërkesat e të autorizuarit të paditurës, sa i përket pretendimit që kërkesa e paditëses është parashkruar në bazë të dispozitës së nenit 357 par.1 të LMD-së. Andaj, gjykata e shkallës së parë bazuar në të lartcekurat dhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, me detaje të tjera të përshkruara më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Këtë gjendjen faktike të çështjes gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 362 par.4, dhe 960 të LMD-së, si dhe nenit 143, 449, 452 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje juridike, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës

kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas Gjykatës së Apelit, janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, pretendimet ankimore të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, lidhur me atë se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për pa i theksuar shkeljet konkrete dhe ku konsistojnë ato shkelje, sepse aktgjykimi i atakuar nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i tij është i qartë në harmoni të plotë me arsyet të dhëna në pjesën arsyetuese të tij dhe se në arsyetimin e tij janë dhënë arsye konkrete për faktet me rëndësi vendimtare për një vendosje të tillë.

Atëherë, pasi që gjendja faktike është e vërtetuar me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, ndërsa nuk mund të pranohen pretendimet ankimore të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës se gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë është vërtetuar gjendja faktike, me arsyetim se kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës së paditëses, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qartë ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe ka marrë vendimin gjyqësor bazuar edhe në dispozitën e nenit 362 par.4 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve ku decidivisht parashihet se *“Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit nga siguruari fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht, ku i siguruari t’ia ketë shpërblyer dëmin”*. Kështu që nga shkresat e lëndës shihet se Ujdia jashtë gjyqësore, në mes të dëmtuarit dhe paditëses, është arritur me dt.19.04.2013, ndërsa urdhri për transfer të mjeteve është bërë po me këtë datë 19.04.2013, ndërkaq *transferi i mjeteve është bërë me dt.30.04.2013*, kurse paditësja padinë e ka parashtruar me dt.06.01.2016, pra brenda afatit 3 vjeçar paditësja e ka ushtruar padinë në gjykatë.

Andaj, nuk qëndron pretendimi ankimor se është parashkruar kërkesa e paditëses, bazuar në dispozitat e nenit 362 par.3 dhe nenit 357 par.1 të LMD-së, ngase siç është theksuar më lartë kërkesa e parashkrimit fillon nga dita kur të dëmtuarit i është shpërblyer dëmi i shkaktuar nga i siguruari, e që në këtë rast, i dëmtuari është shpërblyer për dëmin e shkaktuar me dt.30.04.2013, data kur i është bërë transferi i mjeteve, në shumën e caktuar që rrjedhë nga Ujdia jashtëgjyqësore, me detaje si në shkresat e lëndës.

Prandaj, sipas Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor i përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike bazuar në provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse në rastin konkret.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret, nuk mund të konsiderohet se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale, sepse në situatën konkrete si kjo e paditëses, zbatohen dispozitat të cilat i ka zbatuar edhe gjykata e shkallës së parë në këtë rast, dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerësoi se pretendimet ankimore të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, ishin të pa bazuara dhe të njëjtat nuk patën ndonjë bazë ligjore, për rastin konkret të paditëses në mënyrë që të ndikojnë në marrjen e ndonjë vendimi tjetër, nga ai të cilin e ka marr gjykata e shkallës së parë, qoftë edhe duke e ndryshuar të njëjtin, siç ka propozuar e paditura në rastin konkret.

Gjykatës e Apelit vlerëson se, qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje është i drejtë dhe i ligjshëm, të cilin gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka bazuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Po ashtu, nga Gjykata e Apelit vlerësohet se, gjykata e shkallës së parë, plotësisht i ka vërtetuar faktet të cilat kanë qenë me rëndësi vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore dhe për këto fakte në arsyetimin e aktgjykimit, ka paraqit arsye të plota, sepse të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në detaje janë elaboruar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar.

Prandaj, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje, e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, ndërsa pretendimet ankimore të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës, lidhur me këtë çështje u refuzuan të pa bazuara dhe pa mbështetje në prova bindëse.

Meqenëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, dhe nuk ekzistojnë shkelje esenciale të theksuara në ankesë, as shkelje esenciale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, sipas nenit 194 të LPK-së, konform dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË

Ac.nr.4864/2019, me dt.04.02.2021

Kryetari i kolegjit-Gjykatësi
Gëzim Llluni